

## Ndryshimet në legjislacion

Prill 2017

### Në këtë publikim:

- Ligji nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 05/L-130 për shërbimet;
- Ligji nr. 05L-151 për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST SH.A dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A;
- Ligji nr. 05/L-137 për ratifikimin e marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor;
- Ligji nr. 05/L-127 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/l-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/l-246;
- Ligji nr. 05/l -157 për ratifikimin e marrëveshjes së financimit të projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit të Ibër-Lepencit, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;



### I. Ligji nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 3 prill 2017 dhe se ka për të hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Qëllimi i këtij ligji është të plotësoj dhe ndryshoj Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (ligji bazik), përkatësisht nenet 41 (diskualifikimi dhe shkarkimi nga Bordi i Bankës Qendrore) dhe neni 63 paragrafi 2 (emërimi i auditorëve të jashtëm).

Guvernatori dhe anëtarët tjerë të Bordit të Bankës Qendrore të cilët shkarkohen prej postit kanë të drejtë të ushtrojnë padi pranë gjykatës kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

Sipas këtij ligji, Bordit të Bankës Qendrore tani e tutje nuk i nevojitet më aprovimi nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike për caktimin e auditorit të jashtëm.

### II. Ligji nr. 05/L-130 për shërbimet

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 3 prill 2017 dhe se ka për të hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit, me përjashtim të neneve 8, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 19 nenit 23 paragraf 1, pika 1.1 dhe 1.2, të cilat do të hyjnë në fuqi pesë (5) vite pas publikimit.

Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret që mundësojnë të drejtën e themelimit dhe të ushtrimit të aktivitetit për ofruesit e shërbimeve në Kosovë, duke garantuar njëkohësisht siguri dhe cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.

Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën 2006/123/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 12 dhjetorit 2006 për shërbimet në tregun e brendshëm.

Ky ligj zbatohet për shërbimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve në Kosovë. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për shërbimet e mëposhtme:

- shërbimet jo-ekonomike, me interes të përgjithshëm;
- shërbimet financiare, si shërbimet bankare, kreditimi, sigurimi e ri-sigurimi, pensionet profesionale e personale, letrat me vlerë, fondet e investimeve, pagesat dhe këshillimi për investime;
- shërbimet dhe rrjetet e komunikimit elektronik, infrastruktura dhe objektet e tjera përcjellëse elektronike, të cilat janë të rregulluara me akte të veçanta të miratuara në fushën e komunikimeve elektronike;
- shërbimet në fushën e transportit, përfshirë transportin publik, taksitë, transportin me ambulancë apo automjet të shërbimit mjekësor emergjent dhe shërbimet e portit;
- shërbimet e agjencive për punësim të përkohshëm;
- shërbimet e kujdesit shëndetësor pavarësisht nëse ofrohen ose jo përmes objekteve të kujdesit shëndetësor dhe pavarësisht mënyrave me të cilat organizohen dhe financohen në nivel kombëtar apo nëse ato janë publike a private;
- shërbimet audiovizuale, përfshirë edhe shërbimet kinematografike, pavarësisht mënyrës së prodhimit, shpërndarjes dhe transmetimit, si dhe transmetimet radiofonike;
- shërbimet e veprimtarive të lojërave të fatit të cilat përfshijnë vënien bast të aksioneve me vlerë në para në lojëra të fatit, përfshirë lotaritë, bixhozin në kazino dhe transaksionet e basteve;
- veprimtaritë që kanë të bëjnë me ushtrimin e autoritetit zyrtar;
- shërbimet që kanë të bëjnë me strehimin social, mbrojtjen sociale dhe kujdesin ndaj fëmijëve dhe mbështetjen për familjet dhe individët që kanë nevojë për ndihmë të përhershme apo përkohshme të ofruar nga

shteti, nga ofruesit e autorizuar nga shteti ose nga organizatat bamirëse të njohura si të tilla nga shteti;

- shërbimet për siguri dhe pronë private;
- shërbimet e ofruara nga noterët dhe përmbaruesit, të emëruar me akt zyrtar të Qeverisë.

Ligjet dhe aktet tjera që rregullojnë kushtet për themelimin dhe qasjen në, apo ushtrimin e veprimtarive të shërbimit në Kosovë, harmonizohen me dispozitat e këtij ligji.

Nëse dispozitat e këtij Ligji bien ndesh me ndonjë dispozitë të ligjit të veçantë ose akteve të tjera të Kosovës, të cilat rregullojnë aspekte të veçanta të themelimit dhe ofrimit të shërbimeve në sektorë të veçantë ose për profesione të veçanta, zbatohen dispozitat e atyre ligjeve dhe rregulloreve tjera, nëse janë plotësisht të harmonizuara me acquis të BE.

Sipas kushteve të parapara me këtë ligj, e drejta e themelimit dhe qasja në, ose ofrimi i aktivitetit të shërbimit është i garantuar dhe nuk mund të kufizohet me ligj të veçantë

Brenda pesë viteve, nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministritë dhe organet tjera administrative obligohen të shqyrtojnë të gjitha kërkesat ekzistuese të parashikuara me ligj të veçantë, i cili më detajisht rregullon shërbimet e veçanta për të cilat zbatohet ky ligj, në mënyrë që të vlerësohet përputhja e tyre me dispozitat e këtij ligji.

Brenda afatit të njëjtë kohorë, ministritë kompetente dhe organet tjera administrative e propozojnë ndryshimin e ligjeve të veçanta me qëllim të harmonizimit me dispozitat e këtij ligji.

Për zbatimin e këtij ligji, Qeveria është e obliguar të nxjerr akte nënligjore në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi.

**III. Ligji nr. 05L-151 për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST SH.A dhe**

### **Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A.**

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 prill 2017 dhe se ka për të hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Ky ligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, për shkëmbimin dhe/ose ndarjen e rezervës rregulluese ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST SH.A. dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut – KOSTT SH.A.

Pjesë përbërëse e ligjit është marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar nga ministrat e dy qeverive, e cila më në detaje përcakton obligimet e të dy palëve.

Agjencitë zbatuese të marrëveshjes së bashkëpunimit janë:

- i. Operatori i Sistemit të Transmetimit të Republikës së Shqipërisë (OST);
- ii. Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Republikës së Kosovës (KOST); and
- iii. Rregullatori i Energjisë së Republikës së Kosovës (ERO).

### **IV. Ligji nr. 05/L-137 për ratifikimin e marrëveshjes përkitazi me themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor;**

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 prill 2017 dhe se ka për të hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Ky ligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, nënshkruar në Pragë, më 13 nëntor 2015, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Republikës së Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë ("Palët Kontraktuese").

Qëllimi i Fondit i themeluar nga marrëveshja e përbashkët është të promovoj:

- zhvillimin e bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet Palëve Kontraktuese;

- forcimin e lidhjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese;
- integrimin e Palëve Kontraktuese në Bashkimin Evropian;
- prezantimin e përbashkët të Palëve Kontraktuese në vendet e treta.

Objektivat e Fondit do të ndiqen përmes mbështetjes financiare të aktiviteteve në çdo fushë që kontribuon në bashkëpunimin ndër-rajonal dhe ndërkufitar, dhe në forcimin e kohezionit rajonal.

Selia e Fondit do të jetë në Tiranë, Republika e Shqipërisë, ndërsa organet drejtuese janë:

- Konferenca e Ministrave të Punëve të Jashtme;
- Këshilli i Zyrarëve të Lartë;
- Drejtori Ekzekutiv;
- Sekretariati;

Roli dhe kompetencat e organeve drejtuese janë specifikuar në Aneksin 1 të Marrëveshjes.

### **V. Ligji nr. 05/L-127 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/I-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/I-246**

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 prill 2017 dhe se ka për të hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Sipas ligjit të ndryshuar, secili parashtrues dhe palë kundërshtarë përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës apo odës së avokatëve, përveç Agjencisë, e cila pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përfaqësohet nga personat e autorizuar nga Agjencia, nga radhët e saj ose persona të tjerë të angazhuar.

**VI. Ligji nr. 05/I -157 për ratifikimin e marrëveshjes së financimit të projektit për sigurinë e ujit dhe mbrojtjen e kanalit të Ibër-Lepencit, ndërmjet republikës së Kosovës dhe asociacionit ndërkombëtar për zhvillim;**

Ky ligj është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 prill 2017 dhe se ka për të hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen e Financimit të Projektit për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit të Ibër-Lepencit, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (Asociacioni), nënshkruar më 27 janar 2017 në Prishtinë.

Sipas Marrëveshjes Financiare, e cila është pjesë përbërëse e ligjit, Asociacioni pajtohet të kreditoj në shumë prej njëzet e dy milion euro (EUR 22,000,000) për të ndihmuar në rikthimin e kapacitetit fillestar të kanalit Ibër – Lepenc, për të përmirësuar menaxhimin e burimeve ujore për shfrytëzuesit e ndryshim të ujit të kanalit në Kosovën qendrore (Projekti).

Projekti përbëhet nga pjesët vijuese:

- Pjesa 1. Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës;
- Pjesa 2. Mbrojtja dhe menaxhimi i resurseve ujore; dhe
- Pjesa 3. Menaxhimi i projektit, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi.

## **Kontaktet e Deloitte:**

### **Afrore Rudi**

Drejtoreshë | Shërbime Tatimore dhe Ligjore  
Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Mob.: +386 (0)49 590 807  
Email: [arudi@deloittece.com](mailto:arudi@deloittece.com)

### **Luljeta Plakolli - Kasumi**

Menaxhere | Shërbime Ligjore  
Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Lidhja e Pejës nr. 177,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Mob.: +386 (0)49 780 769  
Email: [lpakollikasumi@deloittece.com](mailto:lpakollikasumi@deloittece.com)

## **Përrjashtim i përgjegjësisë:**

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim I shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të I ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet I rrjetit te Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

\*\*\*

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor te ndare dhe te pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about).

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në saje të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhëne njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.

© 2017 Deloitte Kosova sh.p.k